



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 25.5.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË
KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Igballe Halili udhëheqëse e ekipit, Krenare Pirana dhe Vjosë Bojku, anëtare, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	28
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA.....	29
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	31
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	36

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 20/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion të kualifikuar me Theksim të Çështjës


Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të perfunduara me 31 dhjetor 2016, *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, përveq efekteve të çështjeve së përshkruara në paragrafin e Bazës për Opinon.*

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për bashkëpunimin e ofruar gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore janë:**Përgjigja e Ministrit - auditimi 2016**

Ministri i ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet si dhe është zotuar se do t'i implementojë rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Opinion i auditimit është kualifikuar për shkak të gabimeve si në vijim:

- Pagesat e punëtorëve të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV), në vlerë 373,808€ janë paguar nga buxheti i subvencioneve dhe transfereve, ndërsa 96,695€ të tjera nga buxheti i pagave dhe mëditjeve. Pagesat për MSHV nuk nxjerrin në pah elemente të shpenzimeve që do të plotësonin përkufizimin e “Subvencioneve dhe Transfereve” apo “Pagave dhe Mëditjeve”;
- Pagesat në vlerë 254,792€, për punëtorët e angazhuar për punë në teren, janë bërë sipas një rregullore e cila është e shfuqizuar me vendim të qeverisë; dhe

- Furnizimi me pajisje sportive për shkolla të mesme në vlerë 17,231€, ishte bërë nga investimet kapitale, përdesira këto pajisje i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe kompensimi për punë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës, në vlerë 3,483€ është bërë nga mallrat e shërbimet.

Ministria nuk ka mundur t'i korrigjojë këto gabime gjatë auditimit, pasi që shpenzimet veçse kishte ndodhur. Këto kanë rezultuar në gabime materiale në Pasqyrat Financiare Vjetore dhe për këtë arsye ne kemi kualifikuar opinionin tonë.

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Ministria dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se mungesa e qasjes sistematike për të konfirmuar vlerën e pasurive jo financiare ka rezultuar me një pasiguri mbi vlerën neto të pasurive. Kjo çështje ka ndodhur sepse Ministria nuk kishte marrë veprimet e nevojshme për vlerësimin e të gjithë pasurisë së saj, dhe nuk ishte bërë inventarizimi i pasurisë në fundvit. Opinioni ynë nuk kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MKRS-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë dhe Institucioneve Vartëse.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MKRS kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesa tjera (kërkesat buxhetore; raportet tremujore duke i përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore dhe planin e prokurimit).

Në kontekst të PFV-ve, përveç çështjeve të ngritura tek opinioni i auditimit dhe theksimi i çështjes, kemi identifikuar se në draft PFV ishte e nevojshme të bëhen disa korrigjime financiare. Poashtu kemi dhënë sugjerime të tjera për të përmirësuar cilësinë e tyre. Megjithatë, korrigjimet nuk janë bërë për çështjet në vijim:

- Tek Raporti i ekzekutimit të buxhetit, shënimi 10, në kolonën buxheti final janë prezantuar të hyrat e vitit së bashku me të hyrat e bartura, përderisa duhet të prezantohen vetëm hyrja e parasë së gatshme në llogarinë e thesarit gjatë vitit;

Poashtu tek shpalosjet e pasqyrave financiare kishte gabime si në vijim:

- Pasuritë mbi 1,000€ të shpalosura në PFV nuk përmbanin vlerën e saktë, ngase pagesa prej 40,000€, që ndërlidhet me “Kalanë e Harilaqit” dhe pagesa prej 40,000€ për “Palestrën Sportive në Dardanë faza e II” nuk ishin regjistruar në SIMFK. Poashtu, një semafor i blerë për pallatin e rinisë dhe sportit në vlerë 27,800€, është regjistruar në regjistër, përderisa është dashur të transferohet tek Komuna si menaxhuese e pallatit të rinisë.
- Detyrimet e papaguara nuk ishin raportuar saktë ngase obligimi për pjesëmarrjen në bienale nga viti 2014, në vlerë 55,903€, nuk është shpalosur në PFV;
- Detyrimet kontingjente të shpalosura nuk përmbanin shumat e vlerësuara dhe nuk kishte një vlerë totale të të gjitha detyrimet kontingjente;
- Nuk janë shpalosur informata për numrin e të punësuarave me kontratë për shërbime të veçanta; dhe
- Donacionet e pranuar nga Institucionet Vartëse, me vlerë 142,530€, nuk ishin shpalosur në PFV-të.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale dhe çështje tjera.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur, MKRS ka arritur të dorëzojë me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipërpërmendur të baza për opinion, dhe të shpalosjet tjera të PFV-ve, ne japim rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t’i përcaktuar shkaqet për Kualifikimin e opinionit dhe Theksimin të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t’i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t’i hequr gabimet në keq klasifikime, për t’i evituar pagesat e parregullta dhe për të bërë vlerësimin e saktë të pasurive kapitale; dhe

Rekomandimi 2 Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MKRS-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga Organizata Buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të plotësuar për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Edhe pse MKRS ka arritur disa përmirësime, ende ekziston një numër i dobësive veçanërisht në lidhje me llogaridhënien dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga MKRS, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi aranzhimet ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit nuk ishin vendosur plotësisht. Veprim i mirë konsiderohet ndërprerja e marrëveshjeve për shërbime të veçanta, edhe pse kjo ishte bërë në fund të vitit, dhe shpenzimet për personat e angazhuar më këto marrëveshje, janë reflektuar në PFV dhe kanë ndikuar në modifikimin e opinionit të auditimit.

Edhe më tutje, mbetet sfida monitorimi i institucioneve vartëse, të cilat edhe pse raportojnë në ministri, nuk kanë menaxhim të mirë financiar, dhe llogaritë e tyre bankare në bankat komerciale vazhdojnë të funksionojnë pa autorizim të thesarit. Kontrollet ishin të dobëta dhe në menaxhimin e shpenzimeve posaçërisht në subvencione.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë kryesisht, pagesat për punëtorët në teren dhe mos respektimin e plotë të rregulloreve në fuqi në fushat e subvencioneve, prokurimit dhe personelit.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të MKRS-së ka rezultuar në 24 rekomandime. MKRS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm tri (3) rekomandime janë zbatuar, nëntë (9) janë në proces të zbatimit dhe 12 të tjera nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse MKRS nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, si subvencione dhe transfere; investime kapitale dhe paga dhe mëditje kanë rezultuar në:

- Mos-efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe praktika jo të mira të qeverisjes;
- Mos efikasitet në menaxhimin e projekteve kapitale;
- Mos aplikimi i rregullores për dhënien dhe arsyetimin e subvencioneve;
- Keq klasifikim të shpenzimeve; dhe
- Paraqitje jo të drejtë të pasurive në PFV.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm (AP), me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për OB-të për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MKRS më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 4 Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit të plotësuar nga MKRS ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se plani për menaxhimin e rreziqeve është hartuar për periudhën 2017-2019 dhe nuk e mbulon vitin 2016;
2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk janë të vendosura, pasi që nuk ekziston një plan strategjik në nivel të organizatës. Megjithatë departamenti i Trashëgimisë dhe departamenti i Rinisë kanë strategji të aprovuar për aktivitetet e departamentit; dhe
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga MKRS, dhe dëshmitë që na janë dhënë deri në një masë të caktuar e mbështesin këtë konkluzion, mirëpo raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore.

Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lartë, dhe veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vet-vlerësimi i vitit 2015 ishte i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda MKRS-së, në raport me rëndësinë e këtij pyetësi dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

- Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësorit të vet-vlerësimit, dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MKRS operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

MKRS nuk ka bërë përcaktimin e objektivave strategjike, megjithatë ka planin vjetor të punës dhe planet programore të punës për departamente, që ndërlihet me punën e Institucioneve Vartëse të cilat monitorohen nga MKRS-ja. Përveç sigurimit të buxhetit për funksionimin e institucioneve vartëse, Ministria i mbështet financiarisht edhe projektet e tyre të ndryshme kulturore; rinore, sportive dhe ato të trashëgimisë. Këto mjete pritet të arsyetohen me raporte dhe dëshmi mbështetëse. Mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhë për shumicën e projekteve, pasi që të njëjtat nuk raportohen me kohë.

Çështja 5 – Mungesa e planit të përgjithshëm strategjik – Prioritet i lartë

- E gjetura** Ministria nuk ka një strategji të përgjithshme të objektivave, nuk ka qartësuar përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e planit strategjik, si dhe mungon llogaritja e kostove të strategjisë.
- Rreziku** Paqartësia mbi zbatimin e strategjisë, bënë të pamundur që të përcjellët përmbushja e objektivave në pikëpamje të vizionit të Ministrisë si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të inicojë hartimin e strategjisë së përgjithshme të institucionit si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 6 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura Përkundër faktit që departamentet në kuadër të MKRS-së bëjnë raporte të rregullta të punës së tyre, ne kemi vërejtur se raportet nuk përmbajnë informata të plota të cilat sigurojnë menaxhmentin lidhur me të gjitha aktivitetet brenda organizatës.

Në kuadër të MKRS-së funksionojnë 17 institucione vartëse. Formalisht të gjitha Institucionet kishin raportuar në baza të rregullta kohore (me përjashtim të Kosovafilmit), por përkundër kësaj auditimi ka identifikuar shumë mangësi në menaxhimin e buxhetit nga institucionet vartëse përfshirë tërheqjen e parave nga banka, pagesat me para në dorë dhe keq-klasifikimin e shpenzimeve, që nënkupton se kontrollet menaxheriale kanë qenë të dobëta.

Rreziku Cilësia jo e mirë e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë, redukton aftësinë për të menaxhuar aktivitetet në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim, për të caktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.

Çështja 7 - Proceset e llogaridhënies – Prioriteti i lartë

E gjetura MKRS është përgjegjës për një sërë aktivitete të institucioneve varëse të cilat kanë paqartësi në lidhje me obligimet raportuese. Si rezultat i kësaj llogaridhënie dhe përgjegjësitë përcjellëse për raportim janë të kufizuara dhe nuk zbatohen në mënyrë efektive. Llogaritë bankare të institucioneve vartëse janë në bankat komerciale, menaxhohen nga drejtorët dhe nuk janë të autorizuara nga thesari. Ministria, kohë pas kohe derdh mjete në këto llogari me qëllim të financimit të aktiviteteve të ndryshme të këtyre institucioneve. Si rezultat i kësaj në fund të vitit në llogaritë e institucioneve kishin mbetur një shumë e konsideruar e mjeteve të pashpenzuara, duke ndikuar kështu në rritjen "fiktive" të përqindjes së realizimit të buxhetit.

Rreziku Mungesa e qartësisë ligjore rreth obligimeve reciproke të institucioneve vartëse dhe Ministrisë, dhe kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimit financiar e kanë reduktuar efektivitetin e menaxhimit financiar. Derdhja e mjeteve në llogaritë komerciale të cilat nuk kanë autorizim të thesarit mund të rezultojë me keq-menaxhim të mjeteve.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të iniciojë një rishikim të formës aktuale të raportimit dhe llogaridhënies së institucioneve për të vlerësuar dobësitë dhe për të përcaktuar

aranzhime të përmirësuara. Përveç kësaj Ministri duhet të diskutojë me Ministrinë e Financave dhe Thesarin si dhe me Krerët e Institucioneve vartëse të MKRS-së për të gjetur alternativa më të përshtatshme të menaxhimit të mjeteve financiare të Buxhetit, përfshirë mundësinë që llogaritë aktuale bankare të autorizohen nga Thesari.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy (2) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një (1) auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit efektiv.

Çështja 8 - Mos-funksionimi efektiv i Sistemit të Auditimit të Brendshëm - Prioriteti i lartë

E gjetura	<p>Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Edhe pse NjAB e kishte realizuar planin vjetor, dhe kishte kryer edhe dy (2) auditime shtesë me kërkesë të menaxhmentit, ky plan nuk ishte gjithëpërfshirës, ngase nuk është mbuluar auditimi i institucioneve vartëse; • Rekomandimet e auditimit të brendshëm nuk janë zbatuar nga ana e menaxhmentit; dhe • Kontributi i Komitetit të Auditimit nuk ishte në nivelin e pritur, dhe anëtarët e Komitetit nuk janë të profesionist të fushave adekuate, siç kërkohet me rregullat e auditimit të brendshëm. Përveç kësaj nga procesverbalet e takimeve të komitetit, kemi vërejtur se dy (2) nga anëtarët e komitetit përveç nënshkrimeve të pjesëmarrjes nuk kishin dhënë ndonjë kontribut tjetër.
Rreziku	<p>Mos përfshirja e të gjitha institucioneve në aktivitetet e NjAB-së, pamundëson identifikimin dhe parandalimin e gabimeve dhe zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe financiare. Komiteti i Auditimit jo profesional ndikon në mos raportimin e drejtë tek menaxhmenti.</p>
Rekomandimi 8	<p>Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.</p>

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket MKRS-së, menaxhimi financiar i institucionet varëse mbetet shqetësim i madh, ku nuk janë duke u zbatuar rregulloret duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar Ministrinë që mos të pësojë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhimin jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, menaxhimi i subvencioneve dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	19,876,704	17,088,487	16,773,166	18,874,393	16,780,838
Granti i Qeverisë -Buxheti	19,833,084-	16,485,021	16,255,016	17,598,684	16,378,178
Të hyrat e bartura nga viti paraprak ³	-	32,257	26,520	6,003	9,416
Të hyrat vetjake ⁴	43,620	43,620	26,671	4,224	4,869
Donacionet e jashtme	-	527,589	464,959	1,265,482	388,375

² Buxheti final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi, i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimiet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,788,217€. Ky zvogëlim ishte rezultat i ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit, me rastin e rishikimit të buxhetit, me vendime të qeverisë, me përfshirjen e mjeteve nga donacionet dhe të hyrat vetanake në buxhet.

Në vitin 2016, MKRS ka përdorur 98% të buxhet final ose 16,733,166€, nivel i njëjtë i përqindjes me vitin 2015. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm, duke marrë parasysh se në llogaritë bankare të 16 institucioneve vartëse në fund të vitit kishte mjete të pashpenzuara prej 1,627,891€. Kjo do të thotë që, në PFV-të e Ministrisë këto mjete figurojnë si shpenzime, në fakt ato nuk janë shpenzuar. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	19,876,704	17,088,487	16,773,166	18,874,393	16,780,838
Pagat dhe Mëditjet	3,525,364	3,680,695	3,560,945	3,390,057	3,156,936
Mallrat dhe Shërbimet	725,467	1,435,175	1,363,229	1,552,779	1,235,932
Shërbimet komunale	294,323	318,698	308,555	292,866	275,099
Subvencionet dhe Transferet	6,206,550	7,156,532	7,060,865	7,387,185	5,803,017
Investimet Kapitale	9,125,000	4,497,387	4,479,572	6,251,506	6,309,852

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit final për paga dhe mëditje në krahasim më atë fillestar ishte 155,331€. Kjo është rezultat i shtimit të mjeteve për 60,666€ gjatë rishikimit të buxhetit, të hyrave të bartura prej 11,621€, dhe donacionit nga “Fondi Global” prej 83,044€. Realizimi ishte 97% e buxhetit final;
- Te mallrat dhe shërbimet kishte rritje për 709,708€ në krahasim me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi në fund ishte në nivel 95% e buxhetit final. Rritja e buxhetit përfshin transferin nga investimet kapitale prej 313,431€ dhe nga linja e komunaleve prej 5,000€, nga të hyrat e bartura 20,635€ dhe 393,985€ të tjera nga donatorët e jashtëm. Përkundër rritjeve të lartpërmendura, në fund të vitit në emër të kursimeve Ministria e Financave, e kishte shkurtuar buxhetin për 23,343€. Në këtë kategori fund të vitit kishte një suficit prej 71,876€, ndërsa kishte edhe obligime të papaguara me arsyetimin se kishte mungesë të mjeteve;
- Buxheti për shpenzime komunale ishte rritur për 24,375€. Si rezultat i rishikimit të buxhetit janë shtuar 22,000€ për Bibliotekën Kombëtare, 7,350€ janë shtuar nga linja e investimeve kapitale dhe fondi global 25€. Në të njëjtën kohë kishte një transfer prej 5,000€ nga kjo kategori në mallra dhe shërbime;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte më i lartë për 949,982€ krahasuar me atë fillestar, ndërsa realizimi në fund ishte në nivel 99% e buxhetit final. Fillimisht kishte rritje të

buxhetit me vendim të Qeverisë për 320,000€, pastaj janë transferuar nga Investimet Kapitale shuma 690,000€, dhe nga donacionet e jashtme 50,535€. Derisa në fund në emër të kursimeve buxhetore buxheti është zvogëluar për 110,553€; dhe

- Buxheti final i investimeve kapitale ishte më i ultë për 4,627,613€. Fillimisht kishte një rritje sipas vendimit të Qeverisë 500,000€, pastaj zvogëlim pas transferit në mallra dhe shërbime të shumës prej 313,431€, transferimit të 690,000€, tek subvencionet dhe transferet, dhe 7,350€ tek shpenzimet për shërbime komunale, si dhe shkurtime nga MF me rishikim të buxhetit 775,400€ dhe në emër të kursimeve 3,341,432€. Ndryshimet kaq të mëdha në këtë kategori kanë ardhur si rezultat i planifikimit jo të mirë dhe analizimit të mangët të faktorëve që ndikojnë në realizimin e buxhetit.

Çështja 9 – Planifikimi dhe Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura Edhe pse buxheti është realizuar në masën 98%, nuk mund të thuhet se MKRS kishte performancë të mirë në këtë segment, për arsye se gjatë vitit është shfaqur nevoja për shumë përshtatje, veçanërisht tek Investimet Kapitale. Poashtu në rritjen e përqindjes së realizimit të buxhetit ka ndikuar edhe bartja e një sasive të konsiderueshme të mjeteve në llogaritë bankare të Institucioneve Vartëse, ndërsa këto mjete në fund kanë mbetur si saldo e pashpenzuar.

Një tjetër problem i ndërlidhur me realizimin e buxhetit është keq-klasifikimi i shpenzimeve (shih bazën për opinion të kualifikuar, më lartë).

Rreziku Nevojat e shumta për përshtatje, janë tregues që përgatitja e buxhetit nuk është bazuar në kapacitetet reale të MKRS-së për realizimin e tij. Mos realizimi i projekteve të rëndësishme kapitale rrit rrezikun që të mos arrihen objektivat e përcaktuara të Ministrisë. Keq-klasifikimi i shpenzimeve ndikon në paraqitjen jo të drejtë të shpenzimeve në PFV dhe kjo dërgon në modifikimin e auditimit.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë që përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Përveç kësaj duhet të përmirësohet menaxhimi i projekteve kapitale për tu siguruar se ato përfundohen sipas afateve të kontraktuara dhe me cilësi optimale. Poashtu duhet të sigurohet që shpenzimet të realizohen konform kodeve adekuate ekonomike, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i saktë.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MKRS në 2016 ishin në vlerë 50,785€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shitja e biletave për shfaqje; koncerte; pëlqime etj. Për shkak të vlerës së vogël të hyrave, ne nuk kemi ndonjë çështje që do të ishte e rëndësishme për tu ngritur në këtë raport. Çështjet e identifikuar në lidhje me mënyrën e menaxhimit dhe raportimit i kemi trajtuar si çështje me prioritet të ulët dhe të njëjtat janë diskutuar me personat përgjegjës të Ministrisë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhën përmes një sistemi të centralizuar qeveritar (payroll). Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave kanë të bëjnë me: autorizimin e listës së pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme; rishikimin e buxhetit për këtë kategori, barazimet me thesarin etj.

Çështja 10 – Rekrutime/angazhime në mungesë të procedurave – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Nga tri (3) dosjet e personelit të angazhuar si punëtorë me marrëveshje për shërbimeve të veçanta, vërejtëm se të angazhuarit ishin pranuar pa procedura të rekrutimit, ndërsa për dy (2) nga ta nuk kishte as kërkesë nga departamentet përkatëse.
- Rreziku** Mospërfillja e procedurave me rastin e angazhimit të stafit rrezikon punësimin e personave jo kompetent për pozitat përkatëse. Kjo mund të rezultojë në mos efikasitet operacional si dhe në mos arritjen e objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 10** Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Këto angazhime duhet të zhvillohen konform dispozitave ligjore.

Çështja 11 - Kompensime të parregullta për punonjësit e Ministrisë – Prioritet i mesëm

E gjetura Ne kemi vërejtur katër⁵ (4) raste ku punëtorët kishin pozitat të cilat nuk ishin paraparë në rregulloren për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe përformueseve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore.

Në një (1) rast punëtori me kontratë të rregullt nuk paguhet sipas akt emërimit. Koeficienti në akt emërim ishte shtatë (7) ndërsa në listat e pagave - payroll figuron se paguhet me koeficientin gjashtë (6). MKRS kishte dërguar kërkesat në MF për ndryshim të koeficientit por nuk kishte marrë aprovimin.

E gjetura Parregullsitë e evidentuara në kompensimin e pagave pa qenë konform rregullores dhe kompensimi i punëtorëve jo sipas akt emërimit mund ta sjellin MKRS në detyrime kontingjente.

Rekomandimi 11 Ministri duhet të shqyrtojë rastet e identifikuar dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin bëhet konform rregulloreve në fuqi.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2016 ishte 1,735,872€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,671,785€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues; shërbime; mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

Çështja 12 - Parregullsi në procesin e riparimit të automjeteve -Prioritet i mesëm

E gjetura Në pagesën e bërë për “Riparimin e automjeteve” me vlerë 9,186€ kemi hasur parregullsitë në vijim:

- Bartja e një veture nga vendi i prishjes deri në servis, në distancën prej 182km, është faturuar me 480€. Poashtu nuk dihet as lokacioni prej nga, dhe deri ku është bartur vetura;
- Në dy raste çmimi i faturuar ishte më i lartë se i kontraktuar. Çmimi i faturuar për vajin e motorit ishte 14.24€, ndërsa i kontraktuar 9€, ndërsa Semeringut diferencial, çmimi i faturuar ishte 45.78€, ose pothuajse dyfishi i çmimit të kontraktuar 25€;

⁵ Pozita: Kujdestar i sallës ekspozuese; Punëtorë skenik; Bibliotekistë dhe Rojtar.

- Në shumicën e rasteve, pranimi i veturave të servisuara nuk është bërë si duhet. Përveç që nuk kishte komision të pranimit, mungon nënshkrimi i personit të autorizuar me rastin e pranimit të veturave të servisuara. Në tri (3) raste fletëpranimi kishte vetëm nënshkrim, dhe nuk kuptohet emri i zyrtarit që ka bërë pranimin, tetë (8) fletëpranime kishin nga një mbishkrim “Zyrtari i MKRS” dhe një (1) fletë pranim ishte pa nënshkruar fare.

Përveç kësaj, automjetet e dhëna si donacion nga EULEX ishin servisuar pa kontratë. Vlera e servisimeve të tyre ishte 5,670€.

Këto kanë ndodhur për shkak të mos aplikimit të kontrolleve efektive.

Rreziku Mos aplikimi i kontrolleve përgjatë procesit të servisimit të automjeteve, rrit rrezikun që të ndodhin pagesa të parregullta. Kjo mund të shkaktojë dëmtrim eventual të buxhetit.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të iniciojë një rishikim të zbatimit të kontratës për riparimin e automjeteve, për të përcaktuar shkaqet e ndodhjes së lëshimeve. Njëherit duhet të shtohen kontrollet menaxheriale, për tu siguruar se veturat vërtet riparohen dhe se faturimet për riparimin e tyre bëhen konform kontratës së nënshkruar. Asnjë pagesë nuk duhet të bëhet nëse veturat e riparuar nuk janë pranuar nga personat e autorizuar.

Çështja 13 - Mospërfillja e procedurave të prokurimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas Ligjit mbi prokurimin publik, zyrtari i prokurimit është i vetmi person i autorizuar për të nënshkruar një kontratë publike në emër të autoritetit kontraktues. Ne kemi vërejtur se ministria kishte nënshkruar kontratë për shërbime të telefonisë mobile, me operatorin ekonomik Ipko, pa aplikuar procedura të mirëfillta të prokurimit. Në vend të kësaj SP kishte autorizuar Udhëheqësin e departamentit të financave dhe shërbimeve të përbashkëta, për të nënshkruar kontratën për këto shërbime, pas vlerësimit të ofertave të bërë nga një komision ad-hoc i caktuar nga SP.

Rreziku Kontraktimi i shërbimeve në mungesë të procedurave të mirëfillta të prokurimit, ndikon në zvogëlimin e konkurrencës dhe diskriminimin e ofruesve tjerë të shërbimeve të tilla.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurojë një rishikim në lidhje me rastin në fjalë, për të vlerësuar ligjshmërinë e marrëveshjes si dhe për të vlerësuar nëse shërbimet e kontraktuara janë ekonomike dhe sigurojnë vlerën për parandë e shpenzuar.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Për vitin 2016, buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 7,156,532€. Prej tyre ishin shpenzuar 7,060,865€. Ministria përveç që ndan subvencione për të financuar aktivitetet bazë të Institucioneve varëse, ajo mbështet edhe financimin e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

Çështja 14 - Shpenzimi i mjeteve nga institucionet vartëse të MKRS-së – Prioritet i lartë

E gjetura Auditimi ynë ka vërejtur se menaxhimi i shpenzimeve nuk bëhet çdoherë sipas rregullave në fuqi. Filharmonia dhe Baleti i Kosovës kanë bërë kompensimin e stafit të brendshëm, të angazhuar në projekte, pa ndonjë rregullore, deri në muajin shtator kur është nxjerrë një e tillë. Poashtu, nuk ishte ndalë tatimi në burim në të ardhura personale për kompensimin e artistëve dhe punëtorëve teknik. Për më tutje, këto dy institucione bëjnë pagesa me para në dorë për solistët e huaj të angazhuar në projekte. Vlera e audituar e pagesave kesh është 29,230€.

Institucionet kulturore si: Baleti i Kosovës, Ansambli Shota etj, për kompensimin e shpenzimeve për mëditje me rastin e udhëtimeve jashtë vendit nuk i zbatojnë rregullat e përgjithshme për udhëtime zyrtare. Pagesa për mëditje brenda dhe jashtë vendit paguhet sipas tarifës fikse 40€, edhe pse nuk ka ndonjë rregull të shkruar në lidhje me këtë.

Rreziku Mangësitë në menaxhimin e shpenzimeve të Institucioneve vartëse si dhe mungesa e rregulloreve/udhëzimeve për angazhimin e punëtorëve, e zvogëlojnë efikasitetin dhe e rrezikojnë arritjen e objektivave të projekteve të caktuara dhe të Ministrisë në përgjithësi. Pagesat me para në dorë dëmtojnë transparencën dhe llogaridhënien dhe paraqesin shpenzime të parregullta.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të punojë ngushtë me këshillat drejtuese të institucioneve vartëse me qëllim që të hartojë një rregullore gjithëpërfshirëse për angazhimin dhe pagesën e stafit për projekte të ndryshme, e cila në mënyrë të qartë do të përcaktojë procedurën e angazhimit dhe të kompensimit, ndërsa për mëditje të respektohet udhëzimi administrativ në fuqi. Duhet të zbatohen kontrolle të përmirësuara për të siguruar që të gjitha kompensimet e të angazhuarave të jashtëm të bëhen përmes llogarisë bankare.

Çështja 15 - Arsyetimi i dobët i shpenzimeve nga federatat - Prioritet i mesëm

E gjetura Në vitin 2016, MKRS kishte lidhur memorandume të bashkëpunimit me 18 Federata Sportive, dhe me Komitetin Olimpik. Këto memorandume ishin të mangëta sa i përket përcaktimit të obligimeve të federatave ndaj MKRS-së për arsyetimin e shpenzimeve.

Subvencionet e dhëna për njëmbëdhjetë (11)⁶ federata sportive dhe komitetin olimpik të Kosovës, me vlerë totale prej 794,500€ nuk ishin menaxhuar mirë. Auditimi ka gjetur se në dy (2) raste mjetet e këstit të dytë, ishin derdhur pa u arsyetuar tërësisht kësti paraprak. Derisa kishte mangësi edhe tek arsyetimi i shpenzimeve për drekat, konferencat dhe furnizimeve të veshmbathjeve për sportist, sepse mungonin listat e pjesëmarrësve në konferenca/dreka, dhe atyre që janë furnizuar me veshmbathje. Këto mangësi kishin ndodhur për shkak të monitorimit të dobët të shpenzimeve nga MKRS, dhe mos përcaktimit të obligimeve të ndërsjella në marrëveshjet kontraktuale.

Rreziku Memorandumet e mangëta dhe mos përcaktimi i saktë i obligimeve të palëve si dhe arsyetimi i dobët i shpenzimeve ndikon në menaxhimin jo të mirë të subvencioneve dhe rrit rrezikun që paratë publike të keqpërdoren.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të siguroj që të gjitha memorandumet e mirëkuptimit në mes të ministrisë dhe palëve tjera, t'i përmbajnë edhe obligimet e të dyja palëve, për arsyetimin dhe raportimin e rregullt në lidhje me shpenzimet. Poashtu duhet të shtohen kontrollet në monitorimin e shpenzimeve të krijuara nga federatat.

Çështja 16 - Vonesa në arsyetimin e subvencioneve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas marrëveshjeve të nënshkruara me rastin e dhënies së subvencioneve për projekte të ndryshme, bartësit e projekteve, obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e ndodhura, në afat prej 30 ditësh pas realizimit të aktiviteteve të subvencionuara. Ne kemi gjetur dhjetë (10) raste me vlerë 28,735€, ku subvencionet nuk janë arsyetuar edhe pse aktivitetet e subvencionuara kishin kohë që kishin përfunduar.

Rreziku Mos arsyetimi i subvencioneve mund të ndikojë në mosarritjen e objektivave dhe synimeve të Ministrisë, dhe poashtu rrit rrezikun që fondet të përdoren për qëllime tjera nga ato të planifikuara.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të siguroj që projektet e subvencionuara të monitorohen nga zyrtarët e departamenteve përkatëse në kuadër të Ministrisë, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore për raportimin dhe arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e projektit.

⁶ Federata: Hendbollit; futbollit; volejbollit; kikboxit; pingpongut; peshëngritjes; mundjes; notit; basketbollit; atletikës; dhe shahut.

Çështja 17 - Aprovimi i subvencioneve pas mbajtjes së aktivitetit – Prioritet i mesëm

E gjetura Në shtatë⁷ projekte të subvencionuara nga MKRS me vlerë 16,514€, vendimet, kontratat dhe pagesat për subvencionim ishin bërë pas përfundimit të aktiviteteve të subvencionuara. Edhe përkundër faktit që aktivitetet veçse ishin zhvilluar, arsyetimi i shpenzimeve nuk ishte bërë në dy raste me vlerë 4,000€. Këto raste kanë ndodhur për shkak të bashkëpunimit të dobët në mes të Departamentit të Kulturës dhe Rinisë, dhe zyrës ligjore, gjatë procesit të përpilimit të kontratave.

Rreziku Dhënia e subvencioneve pas përfundimit të aktiviteteve të përkrahura ndikojnë në menaxhim jo të mirë të buxhetit dhe mund të shkaktojnë përdorimin e fondeve në kundërshtim me synimet e planifikuara.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të siguroj që për projektet e përkrahura financiarisht, fillimisht të bëhen vendimet, kontratat, pagesat pastaj të zhvillohen aktivitetet dhe pas aktivitetit të arsyetohen shpenzimet.

Çështja 18 - Mos respektimi i kriterëve për dhënien e subvencionit – Prioritet i mesëm

E gjetura Në dy⁸ raste ishin dhënë subvencione me vlerë totale 3,805€ nga Departamenti i Rinisë, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për vlerësimin e projekt propozimeve. Kriteret që nuk ishin plotësuar janë: dëshmitë e profesionistëve për edukim shëndetësor, përvojë të dëshmuar në zbatimin e projekteve nga edukimi dhe promovimi shëndetësor, dhe afati kohor i implementimit të projektit.

Rreziku Mos respektimi i kriterëve të përcaktuara për përkrahjen financiare të projekteve, mund të ndikoj që ministria të mos i arrin objektivat e caktuara.

Rekomandimi 18 Ministri duhet të siguroj që në të ardhmen, të mos subvencionohen projektet pa i plotësuar kriteret e përcaktuara nga departamenti përkatës.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,497,387€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 4,479,572€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e palestrave sportive; qendrave kulturore, rinore dhe gërmimeve arkeologjike.

⁷ Projektet: “Takimet e Dom Mikel” 2,000€; “Timoni nga Athina” 2,000€; “Festivali I Gitarës” 6,000€; “Promovimi, Motivimi I të Rinjëve për mbështetjen e punës vullnetare” 1,400€; “Femrat e Reja të Emancipuara” 1,840€; “Mobiliteti Shoqërorë dhe Komonikimi” 2,924€; Pjesëmarrje në Ekspozitën e Galerisë Lucas Feichter” 350€.

⁸ Projektet: “Për vetëdijësimin e të ushqyerit të shëndetshëm” 1855€; “Vëzhgo, merr pjesë dhe mëso” 1950€.

Çështja 19 - Shpenzime të parregullta - Prioritet i lartë

E gjetura Shpenzimi i mjeteve në vlerë prej 410,000€ të cilat ishin ndarë për gjashtë⁹ projekte të Institutit Arkeologjik të Kosovës, ishin bërë në kundërshtim me legjislacionin për shkak se:

- Stafi që kishte punuar në realizimin e projekteve ishte angazhuar pa ndonjë procedurë të caktuar të rekrutimit, ndërsa kontratat e tyre ishin nënshkruar pas përfundimit të punëve; dhe
- Shpenzimet tjera të projektit (material shpenzues; mjete për punë dhe shpenzime tjera që janë duhur gjatë gjurmimit) ishin bërë pa ndonjë procedurë të prokurimit, duke anashkaluar ligjin e prokurimit publik.

Për më tepër, Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK) dhe MKRS kanë kompensuar punëtorët profesional dhe punëtorët ndihmës në teren, të angazhuar në realizimin e projekteve të trashëgimisë kulturore të lartpërmendura, me vlerë prej 254,795€, sipas rregullores nr. 01/2009 për pagesën e punëtorëve në teren, e cila është shfuqizuar me vendim të Kryeministrit.

Rreziku Menaxhimi i mangët i procesit të shpenzimeve nga institucionet vartëse, mos zbatimi i procedurave të prokurimit, dhe mungesa e rregulloreve për angazhimin e punëtorëve, rrezikon arritjen e objektivave të Ministrisë. Kompensimi i punëtorëve në teren duke u bazuar në rregullore të shfuqizuara, shkakton shpenzimin parasë publike në mënyrë jo ligjore.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të siguroj që, procedurat e prokurimit janë aplikuar gjatë realizimit të projekteve, dhe të kërkoj nga këshilli drejtues i IAK që të hartojë politika apo udhëzime gjithëpërfshirëse për angazhimin dhe pagesën e stafit për projekte të ndryshme, e cila në mënyrë të qartë do të përcaktojë detyrat, obligimet dhe kompensimet e punonjësve.

⁹

Lokaliteti Ulpiana; Kalaja e Harilaqit; Kalaja e Prizrenit; Lokaliteti i Dresnikut ; Kalaja e Novobërdës dhe Gjurmime arkeologjike me karaktere shpëtimi

Çështja 20 - Procedimi i pagesave pa përfunduar punët – Prioritet i lartë

- E gjetura** MKRS ka vazhduar pagesat ndaj OE i cili nuk i ka përfunduar punët. Bëhet fjalë për Palestrën Sportive në Istog, për të cilën ishte paguar shuma 46,680€.
- Rreziku** Kryerja e pagesave për punët e papërfunduara, është në kundërshtim me normat ligjore dhe mund të ndikojë që kontratat të mos përfundohen. Pagesat e parregullta shkaktojnë humbje financiare.
- Rekomandimi 20** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kanë ndodhur pagesa për punët e porealizuara. Rrjedhimisht, duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme dhe kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë e identifikuar janë adresuar.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Megjithëse ministria kishte bërë përparime sa i përket identifikimit të objekteve dhe pronave të saj, duke formuar një komision për këtë çështje, regjistri i pasurisë ende nuk paraqet pasuritë totale, dhe si i tillë është jo i besueshëm. Kjo pasi që puna e komisionit ende nuk ka përfunduar dhe nuk dihet vlera e saktë e këtyre pronave. Më tej, komisioni për inventarizim nuk kishte një raport të përfunduar për ta pasqyruar gjendjen reale të pasurisë në PVF-të e 2016.

Vlera e pasurisë kapitale në vitin e kaluar ishte 12,698,096€, ndërsa vlera e pasurisë në fund të vitit 2016 në PVF është rritur në 16,989,632€.

Çështja 21 - Menaxhimi i pasurive - Prioritet i lartë

E gjetura Përveç çështjes së cekur tek kapitulli i pasqyrave financiare, tek menaxhimi i pasurive kemi identifikuar edhe çështjet në vijim:

- Komisioni për inventarizimin e pasurive, deri në përfundimin e auditimit, nuk kishte arritur ta bëjë inventarizimin e pasurisë; dhe
- Pasuritë e imëta ishte vështirë të identifikohen sepse nuk ishin të pajisura me barkodet e reja.

Rreziku Mungesa e inventarizimit të pasurisë shkakton mungesë të informatave në lidhje me gjendjen e pasurive, duke vështirësuar menaxhimin e tyre. Mungesa e evidencave të sakta dhe barkodeve mund të shpie në humbjen, keqpërdorimin apo përdorimin e paautorizuar të tyre.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të sigurojë që komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë, në mënyrë që menaxhmenti t'i ketë informatat e sakta rreth gjendjes së pasurive.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 2,146,345€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga MKRS dhe është shqyrtuar më në detaje në nënkapitullin 3.3.

Çështja 22 - Menaxhimi jo efektiv i obligimeve të papaguara - Prioritet i lartë

E gjetura Ministria nuk ka aplikuar proces të mirëfilltë të mbledhjes së faturave prej Institucioneve vartëse, të cilat pastaj të raportohen si obligime të papaguara. Si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë, kishte dy (2) raste kur pagesa për fatura me vlerë 3,471€ të tilla ishin ekzekutuar direkt nga Thesari. Poashtu obligimet e shpalosura në PFV nuk ishin të plota (shih kapitullin 1.3).

Rreziku Mungesa e procesit të mirëfilltë të mbledhjes dhe raportimit të obligimeve shpie në mos pagesë të tyre me kohë dhe mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe mosarritje të objektivave, pasi pagesa tjera mund të ekzekutohen nga Thesari. Poashtu në PVF-të nuk prezantohet vlera e sakët e obligimeve.

Rekomandimi 22 Ministri, duhet të bëjë një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, dhe të bëjë një vlerësim të menjëhershëm të obligimeve, për të marrë masa adekuate për përmirësimin e gjendjes aktuale.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat Financiare	Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Kualifikim të Opinionit dhe Theksimin e Çështjes në 2015 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar prezantim të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2016.			Nuk janë marrë masa.
2. Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Barrierat që pengojnë implementimin e rekomandimeve duhet të raportohen te Ministri dhe të përcaktohen dhe ndërmerren masat e nevojshme për adresimin e tyre.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim i procesit të plotësimit të listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi, në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë përgjigjeve në pyetjet e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Nuk ishte bërë adresimi i fushave me dobësi, si dhe përgjigjet në pyetësor nuk ishin të mbështetura me dëshmi.	

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit të vendosura ndaj institucioneve vartëse si dhe të siguroj aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat specifike.		Nga 17 institucione varëse duke përjashtuar Bibliotekën Kombëtare, vetëm një institucion nuk raporton.	
2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e një qasje të re të menaxhimit e cila do të adresonte rreziqet potenciale që mund të pengojnë arritjen e objektivave të Ministrisë. Hartimi i një regjistri të rreziqeve potenciale do të ishte hap i parë për tu pasuar më tej me veprimet e nevojshme për menaxhimin/zbutjen e këtyre rreziqeve potenciale.		Ndërlidhet me rekomandimin tek pyetëtori i vetvlerësimit.	
2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2016.		Raportimi tek menaxhmenti është përmirësuar, por mungon dokumentimi i rishikimit të raporteve nga menaxhmenti.	
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet ti kushtoj rëndësi më të madhe sistemit të auditimit të brendshëm duke ju ofruar përkrahje të vazhdueshme dhe të nevojshme për punë efektive. KA duhet të rishikojë në mënyrë më kritike planet e NjAB (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe i ofrojnë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe zbatimin e planeve të veprimit			Nuk janë marrë masa.
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që bëhen analiza të vazhdueshme mbi rrjedhën e realizimit të buxhetit në mënyrë që shpenzimet të bëhen në përputhje me planin buxhetor dhe me qëllim të shmangies së parregullsive eventuale si rezultat i devijimeve nga plani. Gjatë planifikimit të investimeve kapitale duhet të merren parasysh edhe faktorët e jashtëm ndikues.			Nuk janë marrë masa.

3.4 Prokurimi	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kanë ndodhur pagesa për punët e pa realizuara, dhe pse nuk janë adresuar të gjitha kërkesat e prokurimit në rastet e përmendura. Rrjedhimisht, duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme dhe kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë e identifikuara janë adresuar.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim i rasteve të mësipërme për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen të vendosen kontrole të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme.	Po		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet që të shqyrtojë rastet e identifikuara dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin e MKRS bëhet konform buxhetit të paraparë dhe në përputhje me kontratat e tyre. Puna jashtë orarit duhet të paguhet në pajtim me normat ligjore dhe vetëm pasi që kërkesa për punë të tillë të jetë aprovuar dhe dëshmuar në formë të dokumentuar.		Në krahasim me vitin paraprak, kishte zvogëlim të rasteve të punës jashtë orarit dhe komensimeve në kundërshtim me rregullat.	
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Këto angazhime duhet të zhvillohen konform ligjit mbi detyrimet. Angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se 6 muaj, dhe pagesa e tyre duhet të bëhet nga mallrat dhe shërbimet. Derisa pozitat e karrierës duhet të mbulohen me punonjës të rregullt konform ligjit për shërbimin civil, në bazë të procedurave të rregullta të konkursit publik.		Pjesërisht, në fund vit ishte ndërprerë praktika e vazhdimit të kontratave me MSHV	
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Në rastet e paraqitjes së pozitive të lira Ministri duhet të sigurojë fillimin sa më të hershëm të procedurave të duhura të rekrutimit për t'ju shmangur mbajtjes së pozitive me UD përtej kohës së lejuar.		Numri i mbulimit të pozitive me UD është zvogëluar krahasim me vitin paraprak.	

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të siguroj që me rastin e dhënies së subvencioneve të respektohen rregullat dhe kriteret, dhe të mos jepen subvencione të cilat nuk janë në harmoni me planin dhe natyrën e punës së Ministrisë.		Edhe këtë vite ka pasur raste të dhënies së subvencionit pas realizimit të projektit.	
	Ministri duhet të sigurojë që realizimi i projekteve të subvencionuara të monitorohet në vazhdimësi për të siguruar respektimin e marrëveshjeve dhe raportimin për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Kjo do të siguronte që qëllimet e synuara me rastin e dhënies së subvencioneve janë arritur.			Nuk janë marrë masa.
	Ministri duhet të siguroj që projektet e subvencionuara të jenë subjekt i monitorimit të rregullt nga zyrtarët e Ministrisë, për të siguruar respektimin e kërkesave/afateve për raportim nga përfituesit për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Aty ku nuk respektohen kërkesat dhe afatet kohore për arsyetimin e shpenzimeve duhet të ndërmerren masat e nevojshme ndëshkuese.			Nuk janë marrë masa.
	Ministri duhet të sigurojë që realizimi i projekteve të OJQ-ve që financohen nga Ministria të monitorohet në baza të rregullta për të siguruar se qëllimet e synuara janë arritur dhe shpenzimet janë arsyetuar me dëshmi relevante.		MKRS kishte vazhduar derdhjen e mjeteve në llogari private të personave, mirëpo jo të OJQ-ve.	
	Ministri duhet të punojë ngushtë me këshillat drejtues të institucioneve vartëse me qëllim që të hartojnë një rregullore gjithëpërfshirëse për angazhimin dhe pagesën e stafit për projekte të ndryshme, e cila në mënyrë të qartë do të përcaktojë procedurën e angazhimit dhe të kompensimit. Duhet të zbatohen kontrole të përmirësuara për të siguruar që të gjitha kompensimet e të angazhuarve të jashtëm të jenë të dokumentuara dhe të bëhen përmes llogarisë bankare.			Nuk janë marrë masa.

	Ministri duhet të vendos kontrole buxhetore më të forta dhe të sigurojë që shpenzimet bëhen në përputhje me qëllimin dhe planifikimin e tyre në mënyrë që të sigurohet shpenzim adekuat i buxhetit dhe klasifikim i duhur i shpenzimeve.			Nuk janë marrë masa.
	Ministri duhet të sigurojë që të gjitha pagesat janë të mbështetura me dëshmi complete, përfshirë kërkesat dhe aprovimet e nevojshme. Të gjitha marrëveshjet për subvencionim të nënshkruhen nga persona kompetent. Një rishikim i kontratave më të shtrenjta se sa ofertat tjera konkurruese është i nevojshëm për të përcaktuar arsyet, duke marrë parasysh se këto projekte nuk janë zbatuar sipas marrëveshjeve.	Po		
3.6 Të Hyrat	Ministri duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm, që mbështet mbledhjen, evidentimin, barazimin dhe raportimin e të hyrave. Të konsiderohet mundësia që duke u bazuar në rregullat e përgjithshme, të krijohen udhëzues praktik për menaxhimin/raportimin e të hyrave nga ana e institucioneve vartëse, për të siguruar që paratë publike po menaxhohen në menyrë të drejtë dhe efikase si dhe të zvoglohen mundësitë e keqpërdorimit eventual të tyre.	Po		
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të sigurojë që komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë në mënyrë që vlera e pasurive e pasqyruar në PVF të jetë e plotë dhe e saktë. Nevojiten aktivitete të shtuara në përfshirjen e të gjitha pasurive në regjistrat kontabël, përfshirë pasuritë e Institucioneve vartëse.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të sigurojë që të bëjë një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, të bëjë një vlerësim të menjëhershëm të borxheve dhe të marrë masa adekuate për përmirësim të gjendjes aktuale.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Veton Firzi

Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

Data: 27 qershor 2017, Prishtinë

